

Syllabus i lëndës

Lënda: Gjuhë turke

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 4 ECTS

Niveli dhe lloji i lëndës: Zgjedhore

Kodi i lëndës: 112

Fondi i orëve: 2+2

VITI AKADEMIK :2015/2016

Semestri: -II-

Mësimdhënësi: Prof. dr. Abdulla Hamiti

Qëllimi dhe përmbajtja e shkurtër e lëndës

Pajisja e studentëve me njohuritë bazë rreth historisë së gjuhës turke. Pas nxënies së alfabetit të gjuhës turke studenti merr njohuritë më të rëndësishme të fonetikës dhe të fonologjisë turke ku do të nxë njohuri për ndarjen e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve turke, theksi e rrokja me ç' rast do të jetë aftësuar për të lexuar drejt turqishten. Studentët do të mësojnë sistemin emëror të gjuhës turke me të gjitha kategoritë e tij si atë të gjinisë, të numrit, të përkatësisë, të rasave duke bërë krahasime me këto kategori të emrit të gjuhës shqipe. Më pastaj do të mësojë edhe mbiemrat, përemrat e numërorët dhe foljen ndihmëse *Imek* e cila u bashkangjitet fjalëve emërore me ç' rast edhe kryen funksionin e kallëzuesit emëror tek fjalitë emërore. Në këtë mënyrë do të zhvillohen shkathtësitë dhe aftësitë e studentëve që të mund të kuptojnë përdorimet e këtyre kategorive gramatikore duke u përpjekur gjithnjë të bëjnë krahasimin me ato të gjuhës shqipe. Do të aftësohen për të mundur të fillojnë të flasin e të shkruajnë turqisht në përputhje me atë nivel që u ofron programi i këtij kursi. Ushtrimet e këtij kursi janë auditive. Qëllimi i ushtrimeve është që studentët të aftësohen për shqyrtim kritik të çështjeve dhe problemeve të trajtuara gjatë ligjeratave, e që kanë të bëjnë me fushën e kësaj lënde. Përpunohen tekste që kanë të bëjnë me tema të ndryshme.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj karakteristikat e fonetikës, fonologjisë e të morfologjisë së gjuhës turke.

Të aftësohen të lexojnë dhe të shkruajnë drejtë në gjuhën turke.

Të mund të përkthejë tekstet e zgjedhura nga gjuha turke.

Të përshkruajë situatat e ndryshme jetësore dhe së paku të jenë në gjendje të konsultojnë literature profesionale në gjuhën turke.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave dhe ushtrimeve ku studentët do të stimulohen për diskutime interaktive, për konverzacion në gjuhën turke ku do të diskutohet praktikisht për atë mësim që është zhvilluar gjatë ligjëratës. Po ashtu do të mbahen seminare, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupore, dhe teste të vetëvlerësimit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe të rezultateve të synuara në mësim.

Përmbajtja e lëndës:

Java e pare: Hyrje, Njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi.

Vokalet: Ndarja e vokaleve, Harmonia vokalike; Klasifikimi i konsonanteve të gjuhës turke; Zëshmeria në nivelin morfonologjik; Bashkëtingëlloret antihijatizuese; Rrokja, akcenti.

Java e dyte: Morfologjia: Karakteristikat e përgjithshme morfologjike të gjuhës turke : morfemat dhe aglutinacioni; Morfemat rrënjore; Morfemat prapashtesore; Llojet e fjalëve; Pjesët e ligjëratës.

Java e tretë: EMRI: Kategoria e gjinisë, kategoria e numrit, kategoria e përkatësisë, kategoria e rasës: lakimi i emrave, përdorimet kryesore të rasave; Kategoria e përcaktueshmërisë – togfjalëshat, lidhja gjenitive: e caktuar, e pacaktuar dhe ajo zinxhirore dhe kuptimet e tyre. Bisedë interaktive, për krahasimin këtyre kategorive të emrit dhe përgjegjëset e tyre në gjuhën shqipe.

Java e katërt: *MBIEMRAT:* Emërzimi i mbiemrave; Llojet e mbiemrave sipas formimit; Shakllët e mbiemrave: pohore, krahasore, sipërore. Përdorimi praktik i mbiemrave duke bashkëbiseduar mesveti.

Java e pestë: *PËREMRAT:* Përemrat vetorë: përdorimi dhe lakimi i tyre; Përemrat dëftorë dhe lakimi i tyre; Përemrat vetëvetortë; Përemrat pyetës, Përemrat e pacaktuar, Përemri lidhor -Ki.

Java e gjashtë: *NUMËRORËT:* Numërorët themelorë; Të shprehurit e moshës, të kohës në orë të minutave e të datave; Numërorët përndarës; Thyesat. Ushtrimi i materies së re në bazë të shembujve.

Java e shtatë: Testi i parë intermedial.

Java e tetë: Folja: Folja jo e plotë *Imek* dhe funksioni I saj si kallëzues emëror. Kallëzuesorët VAR dhe YOK. Foljet e tjera ndihmëse. Ushtrimi I fjalisë së thjeshtë emërore.

Java e nëntë: Foljet e rregullta: Kategoritë gramatikore e foljes: Kategoria gramatikore e diatezës, numrit, mënyrës dhe kohës.

Java e dhjetë: Mënyra dëftore: Kohët e thjeshta të foljes: Koha e tashme me -(i)yor dhe me -r; koha e shkuar e caktuar me -di dhe koha e shkuar e pacaktuar me -mish; koha e ardhme me formantin -(y)ecek,

Java e njëmbëdhjete: Kohët e përbëra të foljes: e pakryera e të shkuarës me -(i)yordu dhe me -rdi; e ardhmja e së shkuarës me formën -(y)ecakti; mëse e kryera me -diydi dhe me -mishti;

Përdorimi praktik i këtyre kohëve foljore në tekstin e zgjedhur turqisht dhe bisedë rreth domethënies së këtyre kohëve të përbëra turke, respektivisht rreth mundësive të përkthimit adekuat të tyre në shqipe.

Java e dymbëdhjetë: Mënyra urdhërore; Mënyra dëshirore; Mënyra e detyrimit dhe Mënyra kushtore; Kuptimet kryesore dhe përdorimet e tyre. Leximi i një teksti të zgjedhur turk dhe përkthimi.

Format foljore infinite: Participët: Pasrticipi i prezentit me prapashtesën *-(y)en/ -(y)an*, participi i prezentit me prapashtesën *-r*; participi me prapashtesën *-dik* dhe *-yecek*; përdorimi sintaksor i proparticipëve me *-dik* dhe *-(y)ecek*; shprehjet ndajfoljore të formuara me proparticipet dhe me korrelatët gjegjës me kuptim kohorë.

Infinitivi: Infinitivi me formën *-mek*, me formën *-meklik*, me formën *-me/-ma*.

Gjerundët: Tipat e ndryshëm të gjerundëve, funksioni i tyre sintaksor dhe barazvlerësit e tyre në gjuhën shqipe.

Java e katërbëdhjetë: Ndajfoljet: llojet e ndajfoljeve; Postpozicionet: Përdorimi i postpozicioneve me rasat e caktuara që kërkojnë ata.

Java e pesëmbëdhjetë: Sintaksë: Fjalja: gjymtyrët e fjalisë Llojet e fjalisë s thjesht dhe të përbërë.

Kriteriumi dhe komponentet e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura themelore- obliguese :

1. Dr. Abdullahu Hamiti, *Gramatika e gjuhës së sotme turke*, Prishtinë, 2002, 285..

Literatura opsionale të cilës student mund t'i qaset për përvetësimin e lendes:

1. Tahsin Banguoğlu, *Türkçenin Grameri*, Baha Matbaası, İstanbul, 1974.
2. Prof. Dr. Muharrem Ergin, *Üniversiteler için Türk Dili*, İstanbul, 1994.
3. Karaman N. Nihal, *Yabancılar için Türkçe metinler*, İstanbul, 1988.
4. Neşe ATABEY, Sevgi Özel, Ayfer ÇAM, *Türkiye Türkçesinin Söz DİZİMİ*, Ankara, 1981.
5. Vecihe Hatipoğlu, *Türkçenin Sözdizimi*, Ankara 1982.

